



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 317, Datë 08.11.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME TË PËRKOSSHME NË PROCEDURAT PËR DHËNIEN E  
GARANCIVE TË ORIGJINËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
BURIMET E RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016;; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.11.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2386 prot., datë 07.11.2023, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënie e Garancive të Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”,

**Konstatoi se:**

- “Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 është hartuar në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
- Ky ligj është shfuqizuar në vijim me ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64, datë 14.04.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas këtij botimi.
- Referuar përcaktimeve të nenit 2 dhe nenit 22, pika 14, të ligjit nr. 24/2023, me kusht që të bëhet tregtimi i garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë, ERE-s i lind detyrimi që t’i bashkohet sistemit rajonal dhe në këtë kuadër, procedurat e ndjekura për këtë qëllim, përveçse me legjislacionin kombëtar në fuqi, konkretisht ligjin nr. 24/2023, duhet të jenë në përputhje dhe me sistemin ligjor të komunitetit, referuar kjo dhe detyrimeve që lindin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE), ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006.
- ERE ka nënshkruar marrëveshjen me konsulentin e përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, kjo sa përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit nr.140, datë 14.04.2023, për

nënshkrimin e marrëveshjes së shërbimit dhe regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.

- Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në ERE është paraqitur kërkesa e një të licencuari për kualifikimin e centralit prodhues si impiant gjenerues i energjisë së rinovueshme.
- Duke qenë se ky aplikim është i pari pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 24/2023 dhe në referencë të përcaktimeve ligjore si më sipër, ERE me shkresën nr. 1937/2 prot., datë 05.10.2023, i është drejtuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në lidhje me implementin e sistemit të garancisë së orgjinës për këto aplikime, për të saktësuar jo vetëm elementet që kanë të bëjnë me natyrën e impianteve prodhuese, por edhe me aspektet që lidhen me kualifikimin si një parakusht ose jo për dhënien e garancisë së origjinës apo kufizimet e mundshme në lidhje me datën e vënies në punë të këtyre impianteve.
- Në përgjigje, me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1397/3 prot., datë 18.10.2023, Sekretariati ka sqaruar se sipas përcaktimeve të Direktivës nr. 2018/2001 Garancitë e Origjinës duhet të përmbajnë informacion në lidhje me “identitetin, vendodhjen, tipin dhe kapacitetin e instaluar të impiantit nga është prodhuar energjia elektrike”, si dhe “burimin nga është prodhuar energjia elektrike, datën e fillimit dhe të mbarimit të këtij prodhimi”. Po ashtu, nga ana e Sekretariatit sqarohet se sipas përcaktimeve të Direktivës nuk ka ndonjë kufizim për sa i përket datës së vënies në punë të impiantit, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga legjislacioni kombëtar.
- Për sa sqaruar nga ligji nr. 24/2023, nuk rezulton që të jetë parashikuar procedura teknike e kualifikimit e po ashtu nuk është përcaktuar ndonjë kufizim kohor në lidhje me vënien në punë apo datën e komisionimit të impiantit, për prodhimin e energjisë elektrike të të cilit kërkohet pajisja me GO.
- Për gjithë sa më sipër vlerësohet që të përcaktohen disa rregulla të përkohshme në lidhje me dhënien e GO-ve të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, deri në miratimin nga ERE dhe hyrjen në fuqi të Rregullores së re për dhënien, transferimin apo anulimin e GO-ve, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023.
- Në referencë të sa më sipër, vlerësohet pezullimi i zbatimit të përcaktimeve të nenit 4.1, nenit 8 dhe nenit 10 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. nr. 229, datë 20.12.2019, për arsye se përcaktimet e këtyre neneve janë mbështetur në Direktivën 2009/28/EC e cila me miratimin e ligjit të ri nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme” nuk është më relevante pasi ligji i ri është përafuar pjesërisht me Direktivën (BE) 2018/2001.
- Në referencë të këtyre ndryshimeve, të licencuarit që paraqesin aplikimin për GO duhet të depozitojnë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga nenet 7.4 dhe 7.5 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar

nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 ose çdo dokument apo informacion të ngjashëm.

- Bordi i ERE-s do të marrë vendim për dhënien ose refuzimin e GO-së, brenda 30 ditëve nga paraqitja e aplikimit në ERE.
- Për sa parashikuar në nenin 11.4 të Rregullores dhe në rrethanat e ndryshimeve të propozuara më sipër, në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes për ofrimin e shërbimit për sistemin rajonal të garancive të origjinës, GO-të e dhëna nga ERE gjatë kësaj periudhe tranzitore do të regjistrohen në regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancive të origjinës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Pezullimin e zbatimit të kërkesave të nenit 4.1, nenit 8 dhe nenit 10 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. nr. 229, datë 20.12.2019 deri në miratimin nga ERE dhe hyrjen në fuqi të Rregullores për dhënien, transferimin apo anulimin e GO-ve, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023.
2. Të licencuarit që paraqesin aplikimin për dhënien e GO-ve deri në miratimin e rregullores së re duhet të depozitojnë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga nenet 7.4 dhe 7.5 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 ose çdo dokument apo informacion të ngjashëm.
3. Për aplikimet për GO që do të paraqiten në ERE gjatë kësaj periudhe tranzitore, bordi i ERE-s do të marrë vendim për dhënien ose refuzimin e GO-së brenda 30 ditëve nga paraqitja e aplikimit në ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**